

VENDIM
Nr.22, datë 12.1.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS PICAR TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Picar, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 439 (katërqind e tridhjetë e nëntë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Picar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Picar

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
5-8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
10,20-25,27,28,30,34-38,302-406	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore	Në pronësi
11-19,26,29,31-33,39	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
40-50,55-58,60-67,69-70,72-79	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
81-85	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
86-87	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
88-92	Varrezat publike	Në pronësi
263-271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
272-276,281,282,285,286,294, 295,299 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
408-409	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi